

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Prishtinë, më 29.04.2024

Vendimi nr. 44/24

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës (tutje AKRK) në mbështetje të nenit 26, paragrafi 1.8 dhe 1.11, neni 27, neni 32, paragrafi 3, neni 55 paragrafi 2, nën paragrafi 2.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur me datën **29 Prill 2024** jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL PËR MARRËVESHJET E FSHEHTA NË PROKURIMIN PUBLIK

- I.** Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, nr. 08/L-056, neni 32, Autoriteti mund të japë mendim profesional ose të publikojë kumtesë për të informuar dhe për të ndërgjegjësuar publikun për konkurrencën në treg, duke përfshirë legjislacionin, politikat dhe zhvillimet krahasuese, të cilat kanë të bëjnë me avokatinë dhe rritjen e kulturës së konkurrencës. Si mjet, avokimi i konkurrencës duhet të ketë një rol të rëndësishëm, për sukses të zbatimit të politikës së konkurrencës, si dhe promovimin e një mjedisi konkurrues për aktivitetet ekonomike.
- II.** Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës dhe misioni i AKRK-së është të nxitë dhe sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të produkteve/shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi, kurse parimi themelor i ligjit të prokurimit publik është krijuar për të garantuar drejtësi, transparencë dhe konkurrencë në procesin e prokurimit që lejon përdorimin efikas dhe efektiv të fondeve publike. Konkurrenca efektive mund të rritet nëse një numër i mjaftueshëm ofertuesish të besueshëm janë në gjendje t'i përgjigjen ftesës për tender dhe të kenë një nxitje për të konkurruar për kontratën.
- III.** Ndërveprimi midis politikave të konkurrencës dhe prokurimit publik është domosdoshmëri. Ato prekin njëra-tjetrën për nevojën për të trajtuar praktikant anti konkurruese ose manipulimin e ofertave në tenderët publik.
- IV.** Manipulimi i ofertave është një praktikë e paligjshme në të cilat palët konkurruese bashkëpunojnë për të përcaktuar fituesin e një procesi tenderimi. Manipulimi i ofertave është një formë e marrëveshjes së fshehtë anti konkurruese dhe është një akt i manipulimit të tregut, kur ofertuesit koordinohen, ai minon procesin e ofertimit dhe mund të rezultojë në një çmim të manipuluar që është më i lartë se ai që mund të ketë rezultuar nga oferta konkurruese në tregun e lirë. Manipulimi i ofertave mund të jetë i dëmshëm për konsumatorët dhe taksapaguesit, të cilët mund të detyrohen të përballojnë koston e çmimeve më të larta dhe kostot e prokurimit.

- V. Institucionet duhet të jenë në mbrojtje të interesit publik, gjithashtu duhet të kujdesen që të krijojnë ambient të përshtatshëm për operatorët aktual dhe nxitës për aplikimin e operatorëve të rinj në tenderët publik. Gjetja/Dyshimi për shenja të mundshme të manipulimit të ofertave nga praktikuesit e prokurimit është sinjal për të kontaktuar Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës dhe të kërkojë që ajo të hetojë shenjat e zbuluara.
- VI. Duke pasur parasysh që prokurimi publik financohet me paratë e taksapaguesve, të gjithë operatorëve ekonomik duhet tu mundësohet të marrin pjesë duke paraqitur oferta dhe/ose propozime për kërkesat për të cilat ata janë të kualifikuar, andaj kërkesat e prokurimit publik duhet të shpërndahen gjerësisht për të rritur shanset për një reagim të mirë të tregut.
- VII. Nga këndvështrimi i politikave të konkurrencës, institucionet publike duhet të kujdesen, që gjatë procesit të hartimit të dosjeve tenderuese të mbizotëroj barazia në trajtim/jo-diskriminimi. Autoritetet kontraktuese duhet të i trajtojnë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe të veprojnë në mënyrë transparente. Autoritetet kontraktuese duhet të kujdesen që përmes kriterëve të mos reduktohet apo eliminohet konkurrenca në mes të operatorëve ekonomik ose që të mos diskriminohet në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.
- VIII. Autoriteti ka vullnetin e plotë për të ndihmuar praktikuesit e prokurimit të zbulojnë manipulimet e ofertave që ndodhin në prokurimin publik.
- IX. Autoriteti, lëshon këtë Mendim Profesional nga pikëpamjet e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela

Florent Mehmeti

Nafije Osdautaj


Salihe Gashi Loku

Nënkryetare

Anëtar

Anëtare

Anëtare






Me këtë Mendim Profesional të njoftohen:

- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Palët e interesit
- Arhiva